



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3064/11 prot.

Datë 18.11.2024

V E N D I M
Nr.1623/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1545/2024, datë 04.11.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: “Mektrin Motor” SHPK me K51408501P dhe adresë: Autostrada Durrës - Tiranë, Km 6, Xhafzotaj, Durrës

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me adresë Rruga: “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë

Subjekt i interesuar: “Classic” SHPK me NIPT J62009007F dhe adresë Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, rruga dytesore, godina nr 8

“Albania Motor Company” SHPK me NIPT K41829010I dhe adresë Tirane, Kashar, Mezez, Autostrada Tirane-Durres, km 2, zona kadastrale 2679

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 04.11.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1545/2024, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr.1354/24 prot., datë 31.10.2024 ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike me datë 04.11.2024 përmes shkresës nr.13254/25prot., datë 01.11.2024 protokolluar me tonën me nr. 3064/3 prot., datë 04.11.2024.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mektrin Motors” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr.1354/28 prot., datë 12.11.2024, protokolluar me tonën nr. 3064/8 prot., datë 13.11.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1545/2024 datë 04.11.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 11.11.2024 për rivlerësimin e procedurës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.1354/28 prot., datë 12.11.2024, protokolluar me tonën nr. 3064/8 prot., datë 13.11.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1545/2024 datë 04.11.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 11.11.2024 për rivlerësimin e procedurës.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomik “Mektrin Motors” SHPK në përputhje me vendimin e KSHA-së së autoritetit kontraktor për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.1545/2024, datë 04.11.2024 ka mbyllur çështjen.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin e KSHA-së së tij për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.1545/2024, datë 04.11.2024 ka mbyllur çështjen për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

